



Ruralbania

# UDHËZUES

**Programi i bursave për fermerët e rinj të  
talentuar në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës**

## **RREGULLA DHE UDHËZIME**

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve:**

**30 Prill 2024, ora 17:00**



## Ruralbania

### Përmbajtja

1.	Qëllimi dhe objektivat e programit.....	4
2.	Financimi dhe kriteret.....	5
3	Ndarja e bursave .....	10
3.1	Punëtori orientuese për fituesit e bursave .....	10
3.2	Kursi i trajnimit.....	10
3.3	Praktika në një biznes relevant me aktivitetin e përfituesit .....	11
3.4	Mbështetja me asete prodhuese dhe teknologji të reja .....	12
4	Raportimi .....	13
5	Monitorimi dhe vlerësimi.....	13
	ANEX 1 Formulari i aplikimit .....	14



## Ruralbania

Programi i bursave për fermerët e rinj të talentuar në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës zhvillohet në kuadër të projektit Ruralbania, financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim [AICS] koordinuar nga RTM – Volontari nel Mondo, në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), ADAD Malore, AgroPuka, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor – Shkodër, Rajoni i Emilia Romagna dhe CIA – Fermerët Italianë.

TË GJITHE TË RINJTË E INTERESUAR PËR TË APLIKUAR NË KËTË THIRRJE

JANË TË INKURAJUAR QË TË KONTAKTOJNË EKIPIN E PROJEKTIT

PËRMES ZYRAVE QABR LOKALE:

QABR Kukës

Rruga Nënë Tereza, Nd Private H2, Kukës

email: [qabr.kukes@gmail.com](mailto:qabr.kukes@gmail.com)

QABR Dibër

Rruga Abdyl Frashëri, Peshkopi

email: [qabr.diber@gmail.com](mailto:qabr.diber@gmail.com)

QABR Pukë

Lagjia e Re Pukë

email: [qabr.puke@gamil.com](mailto:qabr.puke@gamil.com)

TË GJITHA INFORMACIONET DHE DOKUMENTET JANË NË DISPOZICION NË ÇDO KOHË ONLINE NË: [www.anrd.al](http://www.anrd.al)

PËR INFO TË MËTEJSHME NDIQNI RRJETET SOCIALE ANRD dhe QABR

Ky udhëzues u prodhua me mbështetjen financiare të Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim [AICS]. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e ANRD dhe partnerëve, nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.



## Ruralbania

### 1. Qëllimi dhe objektivat e programit

RURALBANIA është një nismë për të mbështetur dhe promovuar produktet bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare.

Ndërhyrja mbështet autoritetet shqiptare dhe shoqërinë civile në zbatimin e Agjendës 2030, duke iu referuar Qëllimit Strategjik të Qëndrueshëm 2 (SDG 2) dhe promovimit të bujqësisë së qëndrueshme (Target 2.3). Në këtë kuptim, Projekti gjithashtu mbështet rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, në kuadër të së cilës përshtatja me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) përfaqëson një element themelor.

Territori shqiptar është kryesisht malor dhe mbi 40% e sipërfaqes së tij përdoret për bujqësi, një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomikë në vend (23% e PBB-së) dhe një burim të ardhurash për shumicën e popullsisë. Prodhimi bujqësor është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Megjithatë, produktiviteti i ulët mbetet një pengesë për rritjen e qëndrueshme, pasi Shqipëria ende importon sasi të konsiderueshme të produkteve agro-ushqimore. Nga rreth 350,000 ferma të pranishme, 86% janë prodhues të vegjël me më pak se 2 hektarë tokë në dispozicion.

Treguesit makroekonomikë të disponueshëm tregojnë zonat e thella të veriut si zonat më të prapambetura të vendit. Prandaj, ndërhyrja synon të rrisë produktivitetin dhe vlerën e shtuar të arritur nga fermat familjare që operojnë në zinxhirë furnizimi me potencial të lartë në zonat malore të pafavorizuara të Shqipërisë së Veriut.

Rritja e produktivitetit arrihet duke garantuar mundësi aksesit për prodhuesit e vegjël bujqësorë në 3 elementë, gurët e themelit të strategjisë së ndërhyrjes:

- ❖ shërbime efektive të asistencës bujqësore dhe rurale
- ❖ trajnime profesionale të kualifikuara për prodhimin bujqësor
- ❖ asete konkrete dhe të qëndrueshme për prodhim dhe shitje

Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, ndërhyrja është krijuar për të lidhur rritjen e të ardhurave të disponueshme me rritjen e produktivitetit. Burimet e reja do t'i çojnë prodhuesit e vegjël në investime të mëtejshme në fermat e tyre dhe shpresojmë në një rritje të madhësisë së tyre. Në aspektin socio-ekonomik, rritja e të ardhurave do të korrespondojë me një reduktim të fermerëve që jetojnë nën kufirin e varfërisë.

Kjo ndërhyrje tre-vjeçare fokusohet në zonat malore fqinje dhe homogjene të Shqipërisë verilindore dhe në zinxhirë të kufizuar prodhimi, për të maksimizuar ndikimin socio-ekonomik në komunitetet si më poshtë:

- Rajoni Lindor i Shkodrës: bletari, fruta pylli



## Ruralbania

- Qarku i Kukësit: mbarështimi i deleve dhe dhive

- Rajoni i Dibrës: pemë frutore

Projekti mbështet veprimin e aktorëve publikë dhe privatë të mëposhtëm të përfshirë në zhvillimin e territoreve të synuara. Mbështetje e privilegjuar është e garantuar për fermat e menaxhuara nga gratë, të rinjtë dhe emigrantët e kthyer, të identifikuar si aktorë strategjikë për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale.

### Objektivi kryesor

Qëllimi i programit të bursave është të ndihmojë në fuqizimin e sipërmarrësve të rinj të angazhuar në sektorin e bujqësisë, në zinxhirët e furnizimit në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Programi synon të identifikojë dhe të ofrojë mbështetje për fermerët e rinj të talentuar në këto zona, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre, si dhe të sigurojnë burime për të rritur dhe zhvilluar bizneset e tyre në fushën e bujqësisë. Për të arritur këtë, programi do të nxisë rritjen e njohurive të tyre përmes kurseve të trajnimit të kualifikuar dhe do të sigurojë mbështetje financiare për blerjen e inputeve të prodhimit, inovacioneve teknologjike dhe diversifikimin e fermave. Përmeshja e këtij qëllimi synon të krijojë një efekt zinxhir që do të mbështesë avancimin e fermerëve të rinj drejt suksesit në sipërmarrje duke kontribuar kështu në zhvillimin rural dhe përmirësimin e cilësinë së jetesës në komunitetet e tyre.

### Objektivat specifikë

- Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të fermerëve të rinj të përzgjedhur përmes trajnimeve të kualifikuara në lidhje me tema të ndryshme të identifikuara nga vetë të rinjtë;
- Përmirësimi i performancës së proceseve të punës të fermave, përmes mbështetjes financiare për investime në asete prodhuese dhe inpute bujqësore.
- Nxitja e përdorimit të praktikave inovative dhe teknologjive të reja për të kontribuar një sektor bujqësor eficient, modern dhe të gjelbër.

## 2. Financimi dhe kriteret

Shuma e përgjithshme e programit të bursave është 30,000 €. Kjo shumë do të mbështesë 10 bursa, secila prej tyre në vlerën prej 3,000€.

Madhësia e bursave:

Çdo aplikim në këtë thirrje duhet të përfshijë shumën maksimale të bursës: 3,000 Euro

Të paktën 3 bursa u dedikohen sipërmarrësve të rinj ruralë.

Bursat do të ndahen në 3 lote që korrespondojnë me 3 fushat e ndërhyrjes:

**Loti 1:** 3 bursa - Zona e synuar Qarku Shkodër;



## Ruralbania

**Loti 2:** 3 bursa - Zona e synuar Qarku Kukës;

**Loti 3:** 4 bursa - Zona e synuar Qarku Dibër.

Në fokus do të jenë zinxhirët e vlerës sipas ndarjes së mëposhtme:

- Rajoni lindor i Shkodrës: bletari, fruta të vogla mali.
- Qarku i Kukësit: mbarështimi i deleve dhe dhive.
- Qarku i Dibrës: pemët frutore.

Bursa mbulon kostot e:

- Regjistrimit në një kurs trajnimi, me kohëzgjatje të ndryshueshme sipas llojit të kursit të kërkuar (maksimumi deri në 4 muaj).
- Një përvojë trajnimi në punë në kompani/organizatë me kohëzgjatje deri në 6 ditë.
- Blerja e inputeve, makinerive të vogla, mjeteve teknike, shërbimeve për marketing dhe dixhitalizim në përputhje me nevojën e secilit pjesëmarrës,
- Shpenzimet e ushqimit, akomodimit dhe transportit lokal të pjesëmarrësit për ndjekjen e kursit.
- Bursa shpërndahet në dy këste: 1) pagesa paraprake për të mbuluar kostot gjatë sesioneve të trajnimit, 2) në fund të seminarit të dytë dhe të fundit, pas miratimit të shpenzimeve të propozuara për kontribut nga juria.

### **2.1 Rregullat e Përfitimit të Bursës**

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e bursave të akorduara:

#### **Kriteret e Pranueshmërisë**

Ekzistojnë tre grupe kriteresh të pranueshmërisë që lidhen me:

- (1) Subjektet e pranueshme
- (2) Aktivitetet e pranueshme
- (3) Kostot e përshtatshme

##### **2.1.1 Subjektet e pranueshme**

Për të pasur akses në programin e bursave, aplikantët duhet të përmbushin kriteret e treguara më poshtë (“kushtet e detyrueshme”):



## Ruralbania

- të jetë një i/e ri/e (18-35 vjeç, në momentin e aplikimit);
- të jetë banues në bashkitë e mëposhtme (zonat e synuara):
  - Qarku Shkodër, Bashkitë: Pukë, Fushë Arrëz;
  - Qarku Kukës, Bashkitë: Has, Kukës, Tropojë;
  - Qarku Dibër, Bashkitë: Dibër, Mat, Bulqizë, Klos.

Aplikanti duhet të dorëzojë aplikim individual. Bashkë-aplikant nuk mund të përfshihen në aplikim.

### **2.1.2 Aktivitetet e pranueshme**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e bursës nuk mund të jetë më e pak se 6 muaj dhe as më shumë se 12 muaj.

#### **Sektorët**

Në kuadër të këtij Programi, aplikantët duhet të propozojnë plane të qarta për sa i përket mënyrës së përdorimit të bursës, me qëllim arritjen e rezultateve të matshme dhe përmbushjen e qëllimit të projekt-idesë.

#### **Lloji i aktiviteteve**

Lista e aktiviteteve të pranueshme përfshinë:

- Regjistrimi në një kurs trajnimi (kusht i detyrueshëm për përfitimin e bursës), me kohëzgjatje të ndryshueshme sipas llojit të kursit të kërkuar (maksimumi deri në 4 muaj).
- Një përvojë trajnimi në punë në kompani/organizatë me kohëzgjatje deri në 6 ditë.
- Blerja e inpleteve, makinerive të vogla, mjeteve teknike, shërbimeve për marketing dhe dixhitalizim në përputhje me nevojën e secilit pjesëmarrës,

### **2.1.3 Kostot e përshtatshme**

Kosto direkte të pranueshme

Thirrja do të mbështesë aktivitetet/të mbulojë kostot e mëposhtme:

- a) trajnim (tarifë regjistrimi për trajnim profesional, tarifa dhe kosto për vizita studimore, kosto udhëtimi, akomodimi, ushqimi);
- b) blerje/qira pajisjesh të vogla, mobiliesh, makinerish, mjeteve, materialesh IT dhe materialesh të tjera;



## Ruralbania

### **Kostot e papranueshme**

Kostot e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- borxhet dhe tarifatat e shërbimit të borxhit (kamatat);
  - parashikimet për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
  - kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një projekt apo program tjetër;
  - blerja, qiraja ose dhënia me qira e tokës dhe objekteve ekzistuese;
  - humbjet e këmbimit valutor;
  - kredi ndaj palëve të treta;
  - kostot e pagave të personelit të administratave publike;
  - detyrimet doganore dhe të importit apo çdo pagesë tjetër;
  - gjokat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e mosmarrëveshjes ligjore;
  - kostot operative të përgjithshme të aplikantit jo të lidhura me zbatimin e projektit në fjalë;
  - pajisje të përdorura;
  - tarifatat bankare, kostot e garancive dhe tarifatat e ngjashme;
  - kostot, tarifatat dhe humbjet e këmbimit valutorë, si dhe shpenzime të tjera thjesht financiare;
  - kontributet në natyrë;
  - taksat,
  - kostot e konsulencës për përgatitjen e aplikimit
  - kostot e bëra para fillimit të zbatimit të projektit.
  - financim retroaktiv për aktivitete që janë tashmë në zbatim ose të përfunduara;
  - subvencione financiare për individë/organizata të tjera;
  - kostot indirekte të shkaktuara në kryerjen e ndërhyrjes
  - kostot e amortizimit të pajisjeve.
- **Sesionet informuese** për të rinjtë e interesuar për të aplikuar do të organizohen nga tre QABR (Qendra të Asistencës Bujqësore dhe Rurale) të lokalizuara në Dibër, Kukës dhe Punë përgjatë muajit mars dhe prill 2024.

### ***Afati i aplikimit***





## Ruralbania

Përgjatë muajit mars, pranë QABR-ve përkatëse do të organizohen ditë informimi për të rinjtë e interesuar, për t'i ndihmuar ata në procesin e aplikimit.

Aplikimet duhet të dërgohen brenda datës 30 prill pranë QABR-ve përkatëse.

### **2.2 Përzgjedhja e kandidatëve**

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet përmes një jurie prej katër anëtarësh. Juria përbëhet nga:

- Koordinator/e i/e RTM-së<sup>1</sup> (Kryetar/e)
- Koordinator/e i/e RYH (Qendrës së Rinisë Rurale) (Anëtar/e)
- Ekspert/e i/e jashtëm<sup>2</sup> (Anëtar/e)
- Sekretari/e<sup>3</sup> (pa të drejtë vote)

Identifikimi fituesve bëhet përmes një procedure me dy faza.

#### 1. Kontrolli administrativ.

Sekretari/e do të kontrollojë dokumentacionin e aplikimit dhe plotësimin e kërkesave thelbësore nga kandidatët, nën kontrollin e kryetarit/es.

#### 2. Vlerësimi teknik.

Juria vlerëson aplikimet për të identifikuar përfituesit sipas kriterëve të mëposhtme:

- Angazhimi në zinxhirët e vlerës të bletarisë, frutave të malit, mbarështimi i deleve dhe dhive dhe pemëve frutore.
- Qasja e mëparshme në trajnime dhe mbështetje financiare.
- Motivimi për të qenë pjesë e programit.
- Niveli i mbështetjes financiare të mëparshme.
- Pikë shtesë nëse kandidati është femër dhe/ose një emigrant i kthyer.

Brenda një muaji nga mbyllja e thirrjes, juria do të hartojë listën e 10 përfituesve të cilët kontaktohen nga QABR-të përkatëse dhe ftohen në Punëtorinë Orientuese.

---

<sup>1</sup> Volontari nel Mondo RTM <https://www.rtm.org/en/progetti-rtm/albania/>

<sup>2</sup> Ekspert me të paktën 5 vjet përvojë në fuqizimin e të rinjve dhe zhvillimin rural, rezident në Shqipëri dhe i përzgjedhur me procedurë të hapur.

<sup>3</sup> Officer i ndërgjegjësimit, mobilizimit rural dhe advokacisë (ANRD)



## Ruralbania

### **3 Ndarja e bursave**

#### **3.1 Punëtori orientuese për fituesit e bursave**

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të pasohet nga zhvillimi i një Punëtorie 2-ditore në një nga fermat e anëtarëve të Qendrës së Rinisë Rurale (RYH)<sup>4</sup>. Përfshirja e RYH do të jetë një eksperiencë frymëzuese për të rinjtë në zonat rurale të Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Takimi i drejtpërdrejtë i përfituesve me një shembull pozitiv të sipërmarrjes dhe aktivizimit rinor rural është një burim motivimi dhe stimulimi për inovacion tek të rinjtë pjesëmarrës.

Në përgatitje për Punëtorinë, secilit pjesëmarrës i kërkohet të plotësojë një pyetësor në të cilin do të tregojë pritshmëritë për përvojën dhe fushat tematike që synon të thellojë.

Qëllimi kryesor i Punëtorisë është rritja e njohurive dhe shkëmbimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe orientimi i tyre në lidhje me kurset e trajnimit që do të ndjekin dhe përvojën në punë. Bazuar në profilet e përfituesve të bursave është përgatitur një listë paraprake e kurseve të trajnimit me certifikim të aftësive nga organet përkatëse (shkolla bujqësore, organizma trajnimi dhe institute) dhe ferma të suksesshme ku mund të kryhen trajnime në vendin e punës.

#### **3.2 Kursi i trajnimit**

Përfituesve të bursës do t'ju mundësohet kryerja e një kursi trajnimi në një qendër trajnimi të zgjedhur nga vetë të rinjtë. Kurset e trajnimit për sipërmarrësit/fermerët e rinj do të variojnë bazuar në nevojat dhe kërkesat specifike të të përzgjedhurve.

#### **Objektivi**

Në përgjithësi kurset e trajnimit synojnë t'i pajisin të rinjtë me aftësitë themelore të sipërmarrjes si planifikimi, marketingu, njohuri mbi praktikatat e mira të prodhimit dhe adoptimi i teknologjisë së re. Megjithatë synimet do të variojnë në varësi të interesit të fituesve të bursës. Rritja e njohurive dhe aftësive do të rrisë produktivitetin dhe do të fuqizojnë të rinjtë e përzgjedhur.

#### **Kohëzgjatja**

Programi i bursave për fermerë të rinj të talentuar zgjat deri në katër muaj, në varësi të specifikave të kursit të trajnimit.

#### **Institucioni ofrues i trajnimit**

---

<sup>4</sup> RYH është një grup joformal rrjetëzimi dhe advokimi për të rinjtë ruralë, i formuar nga ANRD si një mjet për të promovuar aktivizimin rinor



## Ruralbania

Qendra ku do të kryhet trajnimi do të zgjidhet nga vetë përfituesit. Në rastin kur përfituesi nuk ka një qendër të parapëlqyer, përfituesit do të asistohen për përzgjedhjen e qendrës. Institucionet që ofrojnë trajnime për sipërmarrësit e rinj/fermerët duhet të plotësojnë disa kritere për të siguruar efektivitetin dhe ndikimin e programeve të tyre:

*Akreditimi dhe njohja.* Në fund të trajnimit qendra duhet të ofrojë një certifikatë pjesëmarrje.

*Ekspertiza.* Qendra duhet të ofrojë njohuri në fushat specifike për të cilën janë të interesuar përfituesit nga bursa.

*Mundësitë e rrjetëzimit.* Qendra duhet të ofrojë mundësi për pjesëmarrësit që të lidhen me sipërmarrës/fermerë të tjerë, për të ndërtuar një rrjet të mësuarit nga njëri-tjetri.

### **Përfituesi**

Programi i bursave për fermerë të rinj të talentuar do të mbulojë kostot e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit dhe koston e trajnimit. Shuma maksimale që mund të marrë një përfitues në këstin e parë është 1500 Euro, që përfituesi e merr në momentin e fillimit të kursit të trajnimit.

Gjatë trajnimit, përfituesit duhet të mbajnë një "Ditar udhëtimi" në të cilin do të dokumentojnë përvojën përmes fotove, videove dhe tregimeve të shkurtra.

### **3.3 Praktika në një biznes relevant me aktivitetin e përfituesit**

Përfundimi i kursit të trajnimit do të ndiqet nga një praktikë e shkurtër profesionale e cila do t'ju mundësojë të rinjve që të lidhin njohuritë e marra gjatë kursit të trajnimit me përvojën në sipërmarrje/organizata të lidhura me fushën e tyre të interesit.

### **Objektivi**

Praktika ka si synim njohjen e pjesëmarrësve me praktikën e mira të sipërmarrjes/organizatës pritëse dhe mënyra sesi ata mund t'i aplikojnë këto njohuri në aktivitetet e tyre, rrjetëzimin e të rinjve dhe zhvillimin e aftësive personale. Kjo praktikë do të ofrojë një shkëmbim të përvojave, njohurive dhe aftësive.

### **Kohëzgjatja**

Praktika do të zgjasë deri në 6 ditë.

### **Subjekti pritës**

Subjekti pritës duhet të jetë një sipërmarrje, organizatë ose institucion i përfshirë në aktivitetin bujqësor/blegtoral dhe/ose zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale dhe duhet të ketë të paktën 5 vite përvojë. Kërkesa kryesore për subjektin pritës është aftësia dhe gatishmëria për t'i ofruar praktikantit shembuj të praktikave në lidhje me fushën e tij të interesit, si dhe kapacitetet e nevojshme për të lehtësuar dhe monitoruar progresin e praktikantit.



## Ruralbania

### **Përfituesi**

Programi i bursave për fermerë të rinj të talentuar në rrethin e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës do të mbulojë kostot e udhëtimit të praktikantit.

Gjatë trajnimit, përfituesit duhet të mbajnë një "Ditar udhëtimi" në të cilin do të dokumentojnë përvojën përmes fotove, videove, tregimeve të shkurtra.

### **3.4 Mbështetja me asete prodhuese dhe teknologji të reja**

Komponenti i tretë i bursës do të jetë ofrimi i një mbështetje të vogël financiare për blerjen e makinerive të vogla, mjeteve teknike, shërbimeve për marketing dhe digjitalizim.

### **Qëllimi**

Qëllimi kryesor i këtij komponenti është mbështetja e sipërmarrësve të rinj në zonat rurale të krijojnë dhe zgjerojnë bizneset e tyre me ndihmën aseteve prodhuese dhe teknologjive të reja. Kjo do të sjellë rritje të produktivitetit dhe të ardhurave të sipërmarrësve të përfshirë në program.

### **Vlerësimi i nevojave dhe shpërndarja e granteve.**

Do të zhvillohen takime individuale me secilin përfitues për të vlerësuar nevojat dhe qëllimet e tyre të biznesit.

Bazuar në vlerësimin, do të zhvillohet një plan blerjeje i personalizuar për çdo sipërmarrës brenda kufirit total të bursës prej 3000 Euro.

### **Mbështetje për blerje.**

Përfituesve nga bursa do t'ju ofrohet mbështetje dhe udhëzime përgjatë procesit të blerjes së inputeve, makinerive të vogla dhe mjeteve teknike. Kësti i dytë, prej 1500 euro do të jepet në fund të seminarit të dytë dhe të fundit, pas miratimit të shpenzimeve të propozuara për kontribut nga juria.

### **3.5 Punëtorja përfundimtare**

Të rinjtë përfitues të bursave u kërkohet pjesëmarrja në punëtorinë përfundimtare që ka në fokus identifikimin e konkluzioneve dhe vlerësimin e përvojës nga të rinjtë. Punëtorja do të organizohet nga ANRD me synimin e vlerësimit të përvojës së të rinjve përfitues përmes prezantimit të "Ditarëve të Udhëtimit" për të stimuluar shkëmbimin e përvojave, njohurive të mësuara dhe përshtypjeve midis përfituesve të bursave. Në këtë moment të rinjtë përfitues hartojnë propozimin për përdorimin e pjesës së mbetur të bursës dhe blerjes së pajisjeve.

Në përfundim të punëtorisë së fundit, të rinjtë marrim këstin e dytë për të realizuar blerjet sipas planit të paraqitur.



## Ruralbania

### 4 Raportimi

Në përfundim të përvojës, të rinjtë përfitues raportojnë sipas sekuencës më poshtë:

1. Përshkrim i përvojës. Secili nga përfituesit është i lirë të zgjedhë një mënyrë se si do të paraqesë përvojën e tij: krijimi i një blogu, video, ditari ose diçka tjetër. Kjo pjesë do të përfshijë informacion për aktivitetet e kryera dhe njohuritë e fituara.
2. Plani i Veprimit: një përshkrim i shkurtër i ideve se si përfituesi synon të përdorë njohuritë, eksperiencën dhe asetet e përfituara për të zhvilluar më tej sipërmarrjet e tyre.
3. Raporti Financiar. Përfituesi do të dorëzojë një fletë rimbursimi duke përfshirë kopjet origjinalet të të gjitha biletave, faturat e hotelit dhe të çdo shpenzimi tjetër.

#### 4.1 Follow up

Në fund të përvojës, të gjithë pjesëmarrësve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e përvojës, me qëllim që të maten efektet/ ndryshime pozitive në njohuri, aftësi të përfituesve.

### 5 Monitorimi dhe vlerësimi

Pas përfundimit të trajnimit do të bëhen takime në ndërmarrjet bujqësore nga stafi i QABR-ve dhe ekipi i projektit për të parë ndikimin e programit në rritjen e aktivitetit dhe gjenerimin e të ardhurave.

#### Kontakt

Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural: [info@anrd.al](mailto:info@anrd.al)

QABR Kukës

Rruga Nënë Tereza, Nd Private H2, Kukës

email: [qabr.kukes@gmail.com](mailto:qabr.kukes@gmail.com)

QABR Dibër

Rruga Abdyl Frashëri, Peshkopi

email: [qabr.diber@gmail.com](mailto:qabr.diber@gmail.com)

QABR Pukë

Lagjia e Re Pukë

email: [qabr.puke@gmail.com](mailto:qabr.puke@gmail.com)



## Ruralbania

ANEX

1

### Formulari i aplikimit

#### Të dhënat e aplikantit

1. Emër Mbiemër:
2. Moshë:
3. Gjinia:
4. Fshati/Njësia administrative/Bashkia
5. Kontakt: Email: \_\_\_\_\_; Telefon: \_\_\_\_\_
6. Ju lutem bëni një përshkrim të shkurtër të formimit tuaj arsimor.
7. Ju lutem bëni një përshkrim të produkteve kryesore dhe zinxhirit të vlerës ku ju/familja juaj është e përfshirë. (deri në 300 fjalë)
8. Ju lutem bëni një përshkrim të shkurtër të pjesëmarrjes në trajnime gjatë tre viteve të fundit. (deri në 300 fjalë)
9. Ju lutem bëni një përshkrim të shkurtër të mbështetjes financiare që keni marrë gjatë tre viteve të fundit juve dhe/ose familja për aktivitetin bujqësor/blegtoral. (nëse keni marrë / deri në 300 fjalë)
10. A keni kaluar më tepër se 6 muaj jashtë shtetit për arsye pune në 3 vitet e fundit?  
Po Jo

#### Informacion mbi biznesin (nëse është formal)

1. Emri i biznesit dhe NIPT
2. Vendndodhja
3. Përshkruani aktivitetin tuaj:

#### Motivimi dhe përshtatshmëria

1. Shpjegoni pse po aplikoni për këtë bursë dhe si do të përfitoni nga ky program.
2. Shpjegoni se si bursa do të mbështesë shpenzimet tuaja të trajnimit dhe blerjen e aseteve të prodhimit. Trego kostot kryesore dhe shumën përkatëse:

#### Fokusi i trajnimit:



## Ruralbania

1. Specifikoni llojin e trajnimit që keni nevojë (p.sh., menaxhim, marketing, aftësi teknike, etj.).
2. Tregoni nëse keni një ofruer kursi të parapëlqyer apo keni nevojë për rekomandime.

### **Dokumentet Mbështetëse:**

#### **Së bashku me Aplikimin, ju lutem dorëzoni dokumentet si më poshtë:**

1. Dokumenti identifikimi të vlefshëm (Kopje të kartës së identitetit ose pasaportës);
2. Curriculum Vitae (CV) e përditësuar (mundësisht në formatin Europass);
3. Vërtetim banimi në një nga zonat e synuara (“Certifikatë Personale” nga e-Albania, ose vërtetim nga Bashkia përkatëse).
4. Foto/video të aktivitetit